Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencija za Razvoj Poloprivrede/ Agriculture Development Agency

DIVIZIONI PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/ DIVIZIE ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/
/DIVISION OF PUBLIC COMMUNICATION/

THIRRJE PËR APLIKIM

PËR PAGESAT DIREKTE PËR VRESHTA PËR VITIN 2014

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe këtë vit do të vazhdojë të mbështes vreshtarët përmes pagesave direkte për njësi të sipërfaqes-hektarë. Niveli i mbështetjes do të jetë:

- Vreshtarët që kanë të mbjellë (kultivojnë) vreshta **nga 0.10 ha deri 100 ha** do të subvencionohen në vlerë prej **1000 euro/ ha;**
- Vreshtarët që kanë të mbjellë (kultivojnë) vreshta **mbi 100 ha** do të subvencionohen ne vlerë prej **300 euro/ha**.

Fermerët që aplikojnë duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 0.10 ha (10 ari) më vreshta;
- Sipërfaqja e vreshtit e marrë me qera, duhet të jetë e kontraktuar për një vit;
- Sipërfaqja e vreshtit e marrë me qera duhet të jetë 0.10 ha (10 ari) e pandarë.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka per xhirollogarine bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së biznesit dhe numrit fiskal për personat juridik;

- Dëshminë nga kadastri i vreshtarisë mbi sipërfaqen e vreshtit -certifikata e vreshtit **(ky** dokument merret në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave në Rahovec);
- Kontratën për sipërfaqen e vreshtit të marrë me qera;
- Dëshminë që është i regjistruar në regjistrin e fermës;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

Periudha e aplikimit:
Aplikimi zgjatë 30 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes publike.
Aplikimi bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi.

Mënyra e aplikimit:
Të gjithë fermerët fillimisht, gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për regjistrim në Regjistrin e fermerëve, i cili është parakusht për përfitimin e mbështetjes.

- Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MBPZHR Nr.02/2014 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.
- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), e cila vepron në kuadër të MBPZHR-së, do ta menaxhojë implementimin e Programit për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.

Sqarim:

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.
- Realizimi i pagesave për fermerët përfitues të subvencionit do të bëhet me maksimum tri (3) këste.